



REPUBLIKA E KOSOVËS / РИПУБЛИКА КООВОВА / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS МИНИСТАРСТВО ЖИВОТНЕ СРЕДИНЕ, ПРОСТОРНОГ ПЛАНИРАЊА И ИНФРАСТРУКТУРЕ MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr./No.Orig./Udhëzues Orig./Unit	SA-02
Nr./No. i Fajëve Pr. Shënime No./Pages	-04-
Nr./No. i Prot. Brev. Prot. Prot. No.	3198-2/26
Data: Datum:	01.11.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.10.2024
REFERENC-Ë:	24/3198/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"KABI" Sh.p.k., Kmetofc, Gjilan, Përpunim i qumështit dhe prodhimeve të tij.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore



Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "KABI" Sh.p.k., Kmetofc, Gjilan, Përpunim i qumështit dhe prodhimeve të tij dhe ka vendosur si ne Vendim për Leje Mjedisore te bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/3198/MMPHI

Datë: 17.10.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "KABI" Sh.p.k., Kmetofc, Gjilan, **pajiset me Leje Mjedisore** për veprimtarinë: Përpunim i qumështit dhe prodhimeve të tij, në ngastrën nr. P-70403033-01476-0, zona kadastrale, Kmetofc, Gjilan, sipas Vendimit të dhënies së legalizimit, nr.07-350/02-0092058-21.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Vlerat e cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
 - 2.3. Raporti i rezultateve të cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPHI-së;
 - 2.4. Të respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkarkim të ujit;

Faqe 2 nga 4



- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.6. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.7. Për zgjerim te kapacitetit dhe ndryshim te veprimtarisë, operatori obligohet te njoftoj MMPHI-ne.
- 2.8. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin, "KABI" Sh.p.k., Kmetofc, Gjilan, për veprimtarinë: qumështoren në ngastrën nr. P-70403033-01476-0, zona kadastrale, Kmetofc, Gjilan.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 13./3295/-ZSP/206/13, të datës 30.09.2013;
- Leje Ujore Shfrytëzim, me Nr.3280/21-ZSP-2021, data lëshimit: 15.09.2021;
- Leje Ujore Shkarkim me Nr. 3281/21-ZSP-2021.

Bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike duke përfshi shikimin ne vend me zyrtaret profesional, sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si në dispozitiv.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Gjilan;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.